



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2741 Prot.

Tiranë, më 18.05. 2020

UDHËZIM

Nr. 12, datë 18.05.2020

PËR  
MOSORGANIZIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT  
FILLOR, VITI SHKOLLOR 2019-2020, PËR SHKAK TË GJENDJES SË  
FATKEQËSISË NATYRORE TË SHKAKTUAR NGA PANDEMIA E COVID-19

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 50 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Aktit Normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”,

UDHËZOJ:

1. Mosorganizimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, për vitin shkollor 2019-2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia Covid-19.
2. Udhëzimi nr. 5, datë 27.02.2020, “Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor 2020”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI

Besa SHAHINI

